



Demokracia në Veprim
Demokratija na Delu
Democracy in Action

RAPORTI I VËZHGIMIT TË ZGJEDHJEVE


ZGJEDHJET PËR KUVENDE KOMUNALE
DHE KRYETAR TË KOMUNAVE

2017



RAPORTI I VËZHGIMIT TË ZGJEDHJEVE

ZGJEDHJET PËR KUVENDE KOMUNALE
DHE KRYETAR TË KOMUNAVE



Copyright ©2018. Demokracia në Veprim (DnV).

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me mbështetjen e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Zyrës Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K), Agjencisë Daneze për Zhvillim Ndërkombëtar (DANIDA), Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore - Ministria e Punëve të Jashtme të Gjermanisë. Opinonet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e Demokracisë në Veprim dhe jo domosdoshmërisht paraqesin pikëpamjet e donatorëve.

Demokracia në Veprim

Rruga "Bajram Kelmendi" nr. 45
10 000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 38 248 038
www.demokracianeveprim.org

I. Përmbajtja

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
I. KORNIZA LIGJORE	5
II. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE	6
<i>Puna e KQZ-së dhe KVV-ve</i>	6
<i>Regjistrimi dhe certifikim i kandidatëve</i>	7
<i>Certifikimi i Listës së Votuesve</i>	7
III. EDUKIMI DHE INFORMIMI I VOTUESVE	8
IV. FUSHATA ZGJEDHORE	9
V. PROCESI I VOTIMIT	12
<i>Hapja e Vendvotimeve</i>	12
<i>Mbyllja e Vendvotimeve</i>	13
<i>Qasje për Personat me Aftësi të Kufizuar</i>	14
<i>Materiale Propagandues Partiake</i>	14
<i>Materiali Zgjedhor në Ditën e Zgjedhjeve</i>	16
<i>Mungesë tjera të materialit zgjedhor</i>	18
<i>Persona të Paautorizuar</i>	19
<i>Votimi Familjar</i>	19
<i>Fshehtësia e Votës</i>	20
<i>Fotografimi</i>	20
<i>Asistimi i parregulltë i votuesve</i>	21
<i>Tentim për Votim të Dyfishtë</i>	22
<i>Parregullësi dhe Incidentet me Dhunë apo Kërcënim</i>	22
VI. ANKESAT ZGJEDHORE DHE VENDIMET	24
VII. PJESËMARRJA E VOTUESVE	28
<i>Votat e Pavlefshme</i>	29
VIII. REKOMANDIMET	31
<i>Për Reformë Zgjedhore</i>	31
<i>Për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve</i>	31
<i>Për Komisionet Komunale të Zgjedhjeve</i>	32
<i>Për Komisionerët e Vendvotimeve</i>	32

Përmbledhje

Viti 2017 për Kosovën ishte vit i zgjedhjeve pasi në pjesën e parë të vitit u organizuan zgjedhjet e përgjithshme të parakohshme dhe pas disa muajve u organizuan zgjedhjet lokale të rregullta. Organizimi i dy palë zgjedhjeve në një vit, me gjithë logjistikën që kërkon, është sfidë për çdo vend dhe për çdo trup institucion që menaxhon dhe administron zgjedhjet. Megjithatë, Kosova tashmë ka ndërtuar një traditë dhe praktikë të mirë të organizimit të zgjedhjeve dhe institucionet shtetërore iu përgjigjën mirë përgjegjësive të tyre kushtetuese.

Koalicioni i organizatave të shoqërisë civile për vëzhgimin e zgjedhjeve “Demokracia në Veprim” (DnV) kishte të angazhuar mbi 2,500 vëzhgues afatshkurtër për të vëzhguar zgjedhjet lokale, të mbajtura më 22 tetor 2017. Vëzhguesit ishin të vendosur në të gjitha 2505 vendvotimet e 899 qendrave të votimit. Ndërsa për rundin e dytë për zgjedhje të kryetarëve të komunave, angazhoi 1,777 vëzhgues afatshkurtër për të vëzhguar procesin zgjedhor në 19 komuna. Ndërsa shtatë (7) vëzhgues tjerë vëzhguan rivotimin për kryetar në Komunën e Parteshit. Për vëzhgimin e fushatës zgjedhore, DnV kishte të angazhuar 61 vëzhgues afatgjatë, në 30 ditë të fushatës, të cilët përcjellën 1,369 aktivitete të subjekteve politike të certifikuar.

Bazuar në vëzhgimin e gjithë procesit zgjedhor lokal nga Demokracia në Veprim, këto zgjedhje ishin të lira, demokratike të cilave u parapriu një fushatë konkurruese dhe kryesisht e qetë. Procesi për zgjedhje të kryetarëve të disa komunave u komprometua, konkretisht në dy komuna. Në dy komuna në Partesh dhe Istog, zgjedhjet për Kryetarë të Komunës u ripërsëriten dhe procesi u korrigjua përmes ri-votimit. Dalja në zgjedhje lokale ishte më e lartë se në zgjedhjet e përgjithshme të mbajtura po në këtë vit, dhe kjo po del të jetë një trend i vazhdueshëm në Kosovë. Por dalja në këto zgjedhje lokale ishte në nivel më të ulët se në zgjedhjet lokale të vitit 2013 dhe vitit 2009.

Edhe pse procesi zgjedhor në përgjithësi ishte i lirë dhe i drejtë, këto zgjedhje lokale u përcollën me disa sfida nga e kaluara dhe disa sfida të reja që doemos duhet adresuar nga institucionet e Kosovës. Rezultatet e ngushta në disa komuna si Istogu, Prishtina dhe Prizreni shpërfaqën disa mangësi në sistemin zgjedhor që kërkojnë adresim dhe sqarim me legjislacion. Interpretimet e institucioneve gjyqësore pas kontestimit që iu bënë rezultatit në këto komuna ngritën në një masë tensionin në mes të partive që shkaktoj disa paqartësi. Megjithatë, pas vendimeve të institucioneve gjyqësore dhe zgjedhore këto sfida u adresuan në kohë të shpejt dhe subjektet politike u pajtuan me interpretimet dhe vendimet e institucioneve shtetërore.

Votimi me kusht dhe sidomos votimi me postë, në disa komuna, shfaqti mangësitë në rregullsinë e kësaj mënyre të votimit. Në komunën e Istogut votimi me postë u vërtetua të jetë manipuluar. Ndërkaq, këto dy lloj votime e komplikuan procesin e numërimit dhe u përcollën me disa dyshime sikurse në të kaluarën. Rezultatet për komunën e Prishtinës dhe Prizrenit u vendosën nga PZAP që të rinumërohen, mirëpo, pas ankimit, Gjykata Supreme e ktheu prapa këtë vendim.

Këto ishin zgjedhjet e dyta lokale që u organizuan në gjithë territorin e Kosovë, duke përfshirë katër komunat me shumicë serbe në veri të vendit, megjithatë edhe kësaj herë pjesën më të madhe të përgjegjësive në këto katër komuna e morri zyra e OSBE-së në Kosovë, në marrëveshje me Komisionin Qendror Zgjedhor. Tensione u shfaqën edhe në disa komuna me shumicë të komunitetit serb ku kishte disa raste ku u paraqiten presione tek votuesit në

fushatë, incidente në ditë të zgjedhjeve dhe madje edhe raste të manipulimeve që qoj njëri komunën në rivotim.

Hapja dhe mbyllja e vendvotimeve u bë në kohë të caktuar pothuajse në gjitha vendvotimet. Procedurat e hapjes, sigurimit të kutive, prezenca dhe rregullimi i materialit zgjedhor dolën të jenë me rregull. Procedurat e mbylljes së votimit ishin të rregullta. Kishte disa raste të vogla të mos-pajttimeve në numërim, gjithsej në 24 vendvotime të raportuara nga vëzhguesit e DnV-së. Megjithatë, këto u adresuan në Qendrën e Numërimit të KQZ-së.

Sfida të cilat ishin prezentë edhe në të kaluarën ishin votimi me asistencë, i cili në disa raste nga vëzhguesit tanë u raportua të mos jetë i rregullt dhe ligjor. Madje, kjo u shënua në disa raste edhe në rivotimin për Kryetar të Istogut. Pastaj votimi familjar dhe prezenca e materialeve partiake në vendvotime edhe afër qendrave të votimit, edhe pse në masë më të vogël se herën e kaluar, ishin prezentë dhe u evidentuan. Kësaj radhe në disa komuna u paraqitën disa ngatërresa me vultat dhe fletëvotimet pasi vultat kishin shkuar në vendvotime të gabuara, kryesisht në komunën e Deçanit, ndërsa numri i fletëvotimet në katër komuna doli të jetë më i vogël se sa ishin planifikuar. Megjithatë, kjo doli të jetë një ngatërresë logjistike që edhe pse paraqiti pengesa në votim për një kohë të shkurtë u rregullua nga institucionet zgjedhore.

Fushatat zgjedhor po dalin të jenë më të qeta me çdo zgjedhje sipas misionit tonë të vëzhgimit i cili i përcjell fushatat zgjedhore që nga viti 2007. Megjithatë, niveli i ulët i pjesëmarrjes së grave dhe raste me pjesëmarrje të shërbyesve civil dhe shfrytëzim të veturave zyrtare prapë po paraqiten. Transparenca financiare e fushatës zgjedhore nga subjektet politike mbetet në nivel të ulët që ngrit dyshime në financimin e disa nga subjektet politike pasi shpenzimet për fushatë zgjedhor tregohen të jenë të larta. KQZ për herë të parë veprimi për mos certifikimin e kandidatëve me vepra penale në të kaluarën, ashtu siç kërkohet me ligj, megjithatë Gjykata Supreme e ktheu prapa këtë vendim dhe ata kandidatë u certifikuan para ditës së zgjedhjeve. Kjo gjë tashmë mbetet për t'u sqaruar me ligj.

Për të dy raundet zgjedhore, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në total ka pranuar 1,127 ankesa dhe apele. Prej tyre, 448 apo 38% janë refuzuar, 312 apo 27% janë pranuar, përderisa për 415 ose 35% janë marrë vendime tjera (të paraqitura pas afatit, të palejuara ose janë konsideruar si të tërhequra).

Informimi i votuesve për atë se si duhet të votohet, konkretisht për kuvend komunal, dhe se ku duhet të votojnë nuk është avancuar sa duhet. Edhe pse në masë më të vogël se në të kaluarën, prapë u paraqit një numër i konsiderueshëm i votuesve që nuk gjetën vetën në listë të votuesve si rezultat i ngatërimit të vendvotimit të tyre. Ndërsa, niveli i votave të pavlefshme për kuvend komunal del të jetë mbi 8% dhe në disa komuna arriti deri në 13%. KQZ bëri përpjekje të pastroi listën zgjedhore edhe kësaj here duke larguar disa mijëra persona që u vërtetuan tashmë të vdekur megjithatë, numri i elektoratit në listë të votuesve, 1,890,952 votues, prapë u konsiderua jo real dhe kishte raportime për persona të vdekur në këtë listë.

Performanca e komisionerëve të zgjedhjeve kërkon përmirësim. Kishte komisionerë që nuk ishin të përgatitur siç dëshmojnë disa nga rastet në këtë raport. Fakti që mbi 30% të vendvotimeve është dashur të rinumërohen në QNR, tregon që KQZ nuk ka arritur që të ofrojë trajnimin e duhur për komisionerët e zgjedhjeve, çështje kjo e ngritur në vazhdimësi nga shoqëria civile. Është e vërtetë që anëtarët e KVV nominohen nga subjektet politike, por është KQZ ajo që ofron trajnimet dhe gabimet që po bëhen sidomos gjatë procedimit të të dhënave në formularët përkatës po dëshmon që trajnimet nuk po bëhen si duhet. Trajnimet e KQZ-së

për komisionerë duhet të jenë të vazhdueshme, të profesionalizohen edhe më tej dhe të kushtëzohen komisionerët me certifikim para se të shërbejnë në ditë të zgjedhjeve.

II. Korniza Ligjore

Kushtetuta e Kosovës është baza e cila përcakton sistemin zgjedhor, përderisa Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe ai për Zgjedhjet Lokale përcaktojnë detajet e organizimit të zgjedhjeve. Në anën tjetër, aspekte të rëndësishme të mbarëvajtjes së procesit zgjedhor dhe financimit të subjekteve politike janë të rregulluara edhe me Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike si dhe Kodin Penal të Republikës së Kosovës. Dy ligje tjera të rëndësishme të cilat ndërlidhen me zgjedhjet lokale janë edhe Ligji për Vetëqeverisjen Lokale si dhe Ligji mbi Kufijtë Administrativ të Komunave. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) si organ menaxhues i zgjedhjeve po ashtu ka kompetencë për të nxjerr Rregulla Zgjedhore dhe Vendime të cilat shërbejnë për të rregulluar aspekte specifike të procesit zgjedhor. Megjithatë, për zgjedhjet Lokale të vitit 2017, KQZ është shërbyer kryesisht me Rregullat të cilat janë nxjerrë për zgjedhjet qendrore të mbajtura më herët.

Përkundër disa përpjekjeve si nga Kuvendi i Kosovës e së fundmi edhe nga Presidenti i vendit, legjislacioni që rregullon organizimin e zgjedhjeve ka mbetur i pandryshuar që nga viti 2010. Që nga ajo kohë e deri më tani, të gjithë akterët e përfshirë në zgjedhje kanë shprehur nevojën e ndryshimit të legjislacionit, megjithatë, në fund ka munguar një proces serioz dhe gjithëpërfshirës që do të mundësonte një gjë të tillë dhe evitimin e të gjitha atyre mangësive që janë vërejtur. Në këtë aspekt, ndoshta ka kontribuar edhe fakti që Kosova asnjëherë nuk ka mbajtur cikël të rregullt zgjedhor për zgjedhje parlamentare, duke mos lënë kështu edhe hapësirën e duhur për të pasur një reformë të mirëfilltë. Sidoqoftë, vullneti politik është faktori crucial që ka penguar procesin e ndryshimit të legjislacionit. Megjithatë, përkundër zbrazëtirave që janë hasur gjatë zbatimit në praktikë, legjislacioni aktual ka mundësuar bazën që Kosova të organizoi zgjedhje brenda standardeve të pranuar ndërkombëtare.

Sa i përket zgjedhjeve lokale, secila komunë konsiderohet zonë e vetme zgjedhore. Çdo Kuvend i Komunës zgjedhet në mënyrë të drejtpërdrejtë përmes votave të votuesve të cilët janë të regjistruar në komunën ku mbahen zgjedhjet. Subjekti politik paraqet listën e kandidatëve për certifikim për secilën komunë ku merr pjesë në zgjedhje në bazë të procedurave të përcaktuara me Ligji për zgjedhjet e përgjithshme, Ligjin për zgjedhjet lokale, Ligjin për vetëqeverisjen lokale që përcakton numrin e anëtarëve të kuvendeve komunale dhe rregullat e KQZ-së. Çdo listë e kandidateve përmban së paku 30% të kandidatëve të certifikuar nga gjinia tjetër e asaj që është shumicë në listë. Kuota gjinore prej 30% siguron që së paku çdo i treti kandidatë i subjekt politik të jetë nga gjini më pak e përfaqësuar, që aplikohet edhe në ndarjen e ulëseve për deputetë në Kuvend.

Secili subjekt politik i certifikuar paraqitet në listë e cila është e hapur për secilën komunë në të cilën subjekti politik i certifikuar garon në zgjedhje. Duke ushtruar të drejtën e tij/saj të votës, votuesi voton një subjekt politik të certifikuar dhe mund të votoj për një kandidat nga lista e kandidatëve të këtij subjekti politik. Nëse në fletëvotim janë shënuar më shumë se një kandidat, llogaritet vetëm vota për subjektin politik. Vota e hedhur për subjektin politik konsiderohet si votë për kandidatin e parë në listën e kandidatëve të subjektit politik.

Përderisa, legjislacioni për zgjedhje në Kosovë ka një bazë të mirë, Kosova ka nevojë për avancim të legjislacionit zgjedhor dhe kjo sidomos në pjesët ku ka pasur më shumti probleme të evidentuara. Çështja e listës së votuesve, përfshirë edhe votimin nga jashtë vendit, çështja e afateve për parashtrim të ankesave dhe parashtrësive, çështja e financimit të partive politike, kompetencat e mëdha të KQZ-së për nxjerrje të rregullave zgjedhore, programet televizive që transmetohen me pagesë nga partitë politike, si dhe sponsorimet në rrjete sociale, dispozitat se kush mund të garojë për subjektet politike nga pakica, përfaqësimi në trupat menaxhuese zgjedhore, etj.

III. Administrimi i Zgjedhjeve

Puna e KQZ-së dhe KVV-ve

Puna e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve po avancohet me çdo zgjedhje. Transparenca në paraqitjen e rezultateve dhe procesin në Qendrën e Numërimit dhe të Rezultateve është shtuar, që tregon një trend pozitiv. KQZ kishte larguar diku rreth 5,000 persona nga lista e votuesve që u konsideruan si të vdekur. Megjithatë, ditën e zgjedhjeve u vërejt se këta nuk përbënin të gjithë personat e vdekur në listë të votuesve. Misioni i OSBE-së në Kosovë edhe në këto zgjedhje ka asistuar KQZ-në në organizimin e zgjedhjeve në katër (4) komunat veriore të vendit. Në këto komuna është lejuar identifikimi i votuesve me dokumente të shtetit të Serbisë, që është në kundërshtim me legjislacionin vendor.

Megjithatë, ka disa mangësi në funksionimin e KQZ si institucioni përgjegjës për organizimin e zgjedhjeve në Kosovë. KQZ është takuar rrallë dhe nuk kanë ndarë materialet e takimeve duke e vështirësuar procesin e vëzhgimit të këtyre mbledhjeve.

Duke pasur parasysh që zgjedhjet lokale kanë qenë zgjedhje të rregullta, KQZ ka pasur kohën e duhur që të mobilizohet për organizim sa më të mirë të tyre. Edhe pse është vlerësim i përgjithshëm që organizimi i zgjedhjeve lokale në Kosovë ka qenë brenda standardeve të pranuar ndërkombëtare për zgjedhje të lira dhe të drejta, megjithatë shumë probleme vazhdojnë t'a përcjellin organizimin e zgjedhjeve në Kosovë. Gabimet e shumta të komisionerëve gjatë ditës së zgjedhjeve (të evituar më vonë në QNR), vonesat në shpalljen e rezultateve (paraprake dhe finale), lëshimet në procesin e regjistrimit të votuesve nga jashtë, si dhe fushata e vonuar për edukim të votuesve, janë vetëm disa nga të metat që e kanë përcjellë punën e KQZ-së.

DnV vlerëson pozitivisht punën e shumë prej anëtarëve të këshillave të vendvotimeve (KVV) për ndërmarrjen e masave të menjëhershme në adresimin e problemeve që kanë shoqëruar procesin e votimit dhe numërimit. Megjithëse trajnimet më cilësore janë tejet të nevojshme, pasi një pjesë e anëtarëve të KVV-ve nuk i njohin mirë procedurat e votimit dhe veçanërisht plotësimin të formularëve dhe paketimit të materialeve. Prania e grave komisionere është 29.24%.

Fakti që mbi 30% të vendvotimeve është dashur të rinumërohen në QNR, tregon që KQZ nuk ka arritur që të ofrojë trajnimin e duhur për komisionerët e zgjedhjeve, çështje kjo e ngritur në vazhdimësi nga shoqëria civile. Është e vërtetë që anëtarët e KVV nominohen nga subjektet politike, por është KQZ ajo që ofron trajnimet dhe gabimet që po bëhen sidomos gjatë

procedimit të dhënave në formularët përkatës po dëshmon që trajnimet nuk po bëhen si duhet.

Problem tjetër që ka të bëjë me administrimin e zgjedhjeve ka qenë edhe regjistrimi i votuesve nga jashtë, ku si duket, si rezultat i lëshimeve të bëra nga KQZ është dashur që të përsëritet raundi i dytë i zgjedhjeve për kryetar komune në komunën e Istogut.

KQZ në raundin e parë të zgjedhjeve ka dështuar që të ofroj rezultatet paraprake përmes sistemit të ashtuquajtur K-vote, edhe pse shpallja e rezultateve ishte në kohë relativisht të shpjët. Ky problem ishte evituar në raundin e dytë të zgjedhjeve ku sistemi funksionoi shumë më mirë dhe rezultatet paraprake ishin publikuar shumë më herët sesa në raundin e parë.

Ajo çka është vërejtur gjatë zgjedhjeve lokale është që KQZ nuk ka mbajtur mbledhje të shpeshta. KQZ vazhdon akoma të mos jetë plotësisht transparente duke mos ndarë materialet me monitoruesit e mbledhjeve të KQZ, si dhe mospublikimin e shumicës së materialeve në faqen e internetit të KQZ-së. Ndonëse janë mbajtur rreth 70 mbledhje të KQZ deri mes të dhjetorit të vitit 2017, KQZ ka publikuar procesverbalet e vetëm pesë mbledhjeve, përdërisa për asnjë prej tyre nuk i ka publikuar materialet shtesë.

Regjistrimi dhe certifikim i kandidatëve

Me 31 gusht përfundoj procesi i certifikimit të subjekteve politike dhe listave finale (të korigjuara) të kandidatëve për Kuvende Komunale. KQZ ka certifikuar për zgjedhjet komunale të 22 tetorit 91 subjekte politike, nga të cilat 35 parti politike, një koalicion, 30 iniciativa qytetare dhe 25 kandidatë të pavarur. KQZ po ashtu certifikoj edhe 7,080 kandidat të subjekteve politike të cilët garuan për një ulëse në asamblëtë komunale të komunave përkatëse.

Afati i aplikimit për certifikim të subjekteve politike për zgjedhjet lokale filloj nga data 22 qershor dhe përfundoj më 22 gusht 2017. Shorti për renditjen e subjekteve politike në fletëvotim u hodh më 11 shtator 2017, ndonëse në fillim ishte paraparë të hidhej me 6 shtator.

KQZ për herë të parë që nga hyrja në fuqi e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LPZ) në vitin 2008, ka kërkuar verifikimin e kandidatëve të subjekteve politike të cilët janë dënuar për vepra penale në tri vitet e fundit. KQZ, pasi kishte certifikuar kandidatët e subjekteve politike, kishte kërkuar verifikimin nëse të njëjtit janë dënuar për vepra penale në tri vitet e fundit, ashtu siç kërkohet me LZP.


Këshilli Gjyqësor i Kosovës kishte gjetur se 87 kandidatë ishin dënuar në tri vitet e fundit për vepra penale, duke bërë që KQZ të marr vendim për decertifikim të këtyre kandidatëve. PZAP kishte konfirmuar vendimin e KQZ-së, por jo edhe Gjykata Supreme, e cila pas ankesës së tre prej kandidatëve kishte konstatuar se kjo dispozitë ligjore ishte në kundërshtim me Kushtetutën. Si rrjedhojë, KQZ anuloi vendimin e saj për decertifikim dhe iu dha mundësi të gjithë kandidatëve që t'i kthehen garës zgjedhore.

Certifikimi i Listës së Votuesve

Në listën përfundimtare të votuesve kanë figuruar gjithsej 1,890,952 votues, prej të cilëve 18,011 janë votues që kanë pasur të drejtë të votojnë për herë të parë. Mbi 5,000 persona

janë larguar nga lista e votuesve pas zgjedhjeve të 11 qershorit, me qëllim të pastrimit të saj nga personat e vdekur.

KQZ ka aprovuar edhe numrin e qendrave të votimit. Numri i Qendrave të Votimit në këto zgjedhje ka qenë 899 (10 Qendra të Votimit më shumë se në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 11 qershorit), me gjithsejtë 2,505 Vendvotime (15 Vendvotime më shumë se në qershor 2017).



IV. Edukimi dhe Informimi i Votuesve

DnV vlerëson se KQZ ka filluar më vonë informimin dhe edukimin e qytetarëve rreth procesit dhe mënyrës së votimit, përkatësisht vetëm një javë para zgjedhjeve. Përkundër që zgjedhjet lokale 2017 janë organizuar në afat të rregullt kohore. Vëzhguesit tanë kanë raportuar për një numër të rasteve kur qytetarët kanë hasur në vështirësi për të gjetur emrin e tyre në listat e votuesve, si dhe kanë gjetur familjarët e tyre të vdekur në listë. Kjo dëmton besimin e publikut në saktësinë e listë së votuesve.

Numri i madh i fletëvotimeve të pavlefshme pjesërisht lidhet edhe mungesën e informimit dhe edukimit të duhur të votuesve. Përveç që ka filluar me vonë, KQZ nuk po arrin që fushatën e vetë informuese t'a vendos përtej shabllonëve të krijuar vite më parë duke mos i bërë kështu fushatat aspak atraktive për votuesit. Megjithatë, KQZ ka filluar një bashkëpunim me OJQ duke ju dërguar atyre spotet televizive dhe materialet tjera të përgatitura nga KQZ dhe OJQ-të kanë shpërndarë ato materiale përmes faqeve të tyre të internetit.

Megjithatë, për zgjedhjet e ardhshme KQZ duhet që të gjejë mënyra që fushata e saj edukuese dhe informuese të filloj me kohë, të jetë më atraktive dhe të thellohet bashkëpunimi me organizatat jo-qeveritare. Për më tepër, KQZ do të duhej të organizonte fushata edukimi të votuesve edhe jashtë periudhës zgjedhore në mënyrë që qytetarët të kenë njohuritë e duhura mbi rëndësinë e pjesëmarrjes në zgjedhje dhe procedurat e votimit.


V. Fushata Zgjedhore

Demokracia në Veprim gjatë fushatës zgjedhore kishte angazhuar 61 vëzhgues afatgjatë ndërsa për zgjedhjet e balotazhit 30 vëzhgues afatgjatë. Në përgjithësi, DnV ka vëzhguar 1,369 aktivitete të partive politike në fushatë, afërsisht të gjitha aktivitetet që kanë qenë publike dhe janë bërë të ditura për vëzhguesit e DnV-së. Më së shumti aktivitete të vëzhguara ishin nga PDK, 326 sosh, pastaj të LDK-së 302 sosh, LVV-së 302 aktivitete, AAK 137 aktivitete, NISMA-së 91 aktivitete, AKR-së 85 aktivitete, Alternativa-së 13 aktivitete dhe 113 aktivitete të partive tjera garuese.

DnV vlerëson se fushata zgjedhore është zhvilluar e qetë, në një ambient konkurrues ku subjektet politike kanë shpalosur programet e tyre qeverisëse dhe kandidatët për kryetar komunash dhe kuvende komunale. Gjatë fushatës zgjedhore pjesëmarrja e qytetarëve dhe e mediave në aktivitetet zgjedhore të zhvilluara nga subjektet politike ka qenë e sigurt dhe e papenguar. Ndërsa, janë shënuar një numër i vogël i incidenteve të cilat kanë qenë raste të izoluara që nuk e kanë dëmtuar fushatën zgjedhore.

Fushata zgjedhore në komunat me shumicë serbe është zhvilluar në një ambient më të tensionuar dhe ku ka munguar fryma e konkurrencës së lirë në mes subjekteve politike. Prania dhe ndikimi i drejtpërdrejt i zyrtarëve shtetëror serb kanë synuar ndikimin në vullnetin e lirë të qytetarëve se për kë të votojnë.

Një dukuri e mungesës së transparencës së shpenzimeve në fushata zgjedhore po i përcjell proceset zgjedhore në Kosovë, dhe njëjtë ka qenë edhe në këto zgjedhje. Vetëm një numër i vogël i subjekteve politike përkatësisht gjashtë (6) i janë përgjigjur pozitivisht kërkesës së DnV-së për deklarimin e shpenzimeve të tyre për fushatën zgjedhore.




Gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhje lokale 2017, pjesa më e madhe e aktiviteteve të zhvilluara nga subjektet politike kanë qenë tubime zgjedhore me deri në 100 pjesëmarrës, takime me qytetarët, grupe të interesit dhe takime derë më derë. Java e fundit e fushatës zgjedhore ka shënuar një intensifikim të aktiviteteve zgjedhore të subjekteve politike dhe takimeve me qytetarë deri me 1,000 pjesëmarrës.

Parregullsitë më të shumta që e kanë shoqëruar fushatën zgjedhore kanë qenë përdorimi i resurseve publike përkatësisht përdorim i automjeteve zyrtare, pjesëmarrje e shërbyesve civile dhe personave zyrtar në fushatë. Veturat zyrtare janë raportuar në dhjetë (10) aktivitete zgjedhore të PDK-së, katër aktivitete të LDK-së, dy aktivitete të NISMA-së dhe tri (3) aktivitete të partive tjera. Ndërsa, prezenca e shërbyesve civil në një masë të konsiderueshme janë raportuar në 37 aktivitetet të PDK-së, 17 aktivitete të LDK-së, 3 aktivitete të AAK-së, LVV-së, AKR-së dhe NSIMA-së, dhe dy (2) aktivitete të partive me përkatësi serbe.

Subjektet politike kanë qenë më të përmbajtura në përdorimin e gjuhës së urrejtjes, gjithsesi gjatë aktiviteteve zgjedhore të subjekteve politike janë shënuar raste të përdorimit të gjuhës së urrejtës, për të cilat PZAP ka shqiptuar edhe gjopa. Gjuhë e urrejtjes është raportuar në nëntë (9) aktivitete të PDK-së, pesë (5) aktivitete të LDK-së, tri (3) aktivitete të LVV-së, dy (2) aktivitete të NISMA-së dhe tri (3) aktivitete të partive me përkatësi serbe.

Përfshirja e fëmijëve në fushatë zgjedhore në aktivitetet e subjekteve politike ka qenë një problematikë e evidentuar në 30% të aktiviteteve zgjedhore të monitoruara nga DnV dhe numri total i tyre në këto aktivitete ka qenë 3,994 fëmijë. Ndërsa qasja për personat me aftësi të kufizuara nuk është garantuar në 29% të aktiviteteve zgjedhore të subjekteve politike.




Gjatë fushatës zgjedhore pjesëmarrja e grave ka qenë e ulët ndërsa vetëm 8 gra kanë qenë kandidatë për kryetare të komunës nga 204 kandidatë. Pjesëmarrja e grave ka vazhduar në nivele të ulëta gjatë gjithë periudhës së fushatës zgjedhore. Në të gjitha aktivitetet e monitoruara nga DnV pjesëmarrja e grave ka qenë në mesataren 10%. Ndërsa sa i përket pjesëmarrjes së grave si folëse ka qenë 21%.

Në shumicën e rasteve të monitoruara

Policia e Kosovës është përkujdesur për sigurimin e aktiviteteve zgjedhore. Për 30 ditë të fushatës shihet që gjysma e aktiviteteve që janë mbajtur nga subjektet politike nuk kanë pasur fare sigurim. Ndërsa media kanë qenë të pranishme në 51% të aktiviteteve zgjedhore të subjekteve politike dhe kanë mundur të raportojnë lirshëm.



Fushata zgjedhore për raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetar të komunave është zhvilluar e qetë me numër të vogël të parregullsive. Subjektet politike kanë qenë të matura dhe kanë kontribuar në zhvillimin e një fushate zgjedhore konkurruese dhe të qetë ku kanë shpalosur para qytetarëve opsionet dhe programet e tyre. Parregullsitë më të shumta që e kanë shoqëruar fushatën zgjedhore kanë qenë: i) përdorimi i resurseve publike, ii) pjesëmarrje e fëmijëve në aktivitetet zgjedhore; iii) mungesë e qasjes për personave me aftësi të kufizuara. Fushata zgjedhore është dominuar prej kandidatëve burra si në publik ashtu edhe si folës në aktivitetet e subjekteve politike.



VI. Procesi i votimit

Hapja e Vendvotimeve


Qendrat e votimit në të gjithë vendin duhet të jenë të gatshme për të pritur votuesin e parë në orën 07:00 në mëngjesit. Ndërsa përgatitjet për të filluar procesin e votimit duhet të fillojnë në orën 06:00. Kjo procedurë përfshinë bërjen gati të kutive të votimit, vendosjen e materialit sensitive dhe jo-sensitive në vendet e veta, kontrollimin e nënshkrimit të komisionerëve që do të shërbejnë atë vendvotim dhe vëzhguesve partiak e jopartiak që do të vëzhgojnë atë ditë. Vëzhguesit e DnV-së ishin të udhëzuar dhe të trajnuar që të vëzhgojnë procesin e votimit që nga përgatitjet në ora gjashtë të mëngjesit.

Nga të dhënat e vëzhguesve tanë del se 7,8%, apo 164 vendvotimeve të raportuara me 22 tetor filluan përgatitjet pas orës 6:30 ndërsa 5,9% hapen detyrë e vendvotimit me së paku 10 minuta vonesë. Ndërsa me vonesë më shumë se 30 minuta kishin 16 vendvotime. Rastet më të shpeshta ishin në Prizren (22 vendvotime), Deçan (22 vendvotime) pastaj në Mitrovicë (9 vendvotime) e Gjakovë (8 vendvotime). Në balotazh me 19 nëntor, vetëm 12 vendvotime u hapen me mbi pesë minuta vonesë. Komunitat ku ka pasur vonesë në hapje janë Prizreni (në 5 raste), Suharekë (në 3 raste), Prishtinë (në 2 raste) dhe Klina dhe Rahoveci (nga një rast).



Megjithatë, vëzhguesit tanë nuk raportuan për ndonjë vonesë të qëllimshme apo për të cenuar të drejtën e votës por se vonesat ishin për shkak të përgatitjeve dhe kompletimit të komisionit të vendvotimit. Në Deçan kishte disa ngecje në hapjen e vendvotimeve si rezultat i ngatërresës së vulave. Kurse në disa komuna si ajo e Prizrenit, qendra e votimit 2042 A, vendvotimin 07R, kryesuesi i vendvotimit nuk ishte paraqitur në vendvotim deri në orën 7:30. Mirëpo edhe në këtë rast, procesi më pastaj ka rrjedhur normalisht.


Gjatë përgatitjeve, para hapjes së vendvotimit, ndër punët më kryesore të komisionerëve është dhe procedura që duhet ndjekur për kutitë e votimit. Së pari komisionerët duhet të tregojnë të gjithë të pranishmëve që kutitë e votimit janë të zbrazëta, para se të mbyllen. Përderisa, kjo ndodhi dhe ishte e qartë për të gjithë komisionerët dhe vëzhguesit në 99,2% të vendvotimeve, në 20 vendvotime kutia nuk u tregu qartë se ishte e zbrazët. Në qendrën e votimit 1802X në vendvotimin 03R në shkollën “Naim Frashëri” në komunën e Podujevës, edhe pse vendvotimi është hap me kohë shiritat mbyllës në kutinë e votimit nuk janë vendos deri në orën 7:43, arsyetimi ka qenë se kanë harruar komisionerët ta vendosin.



Megjithatë, vëzhguesit nuk raportuan për ndonjë dyshim për lëshime procedurale të këtyre vendvotimeve. Në zgjedhjet për balotazh ky lëshim i lehtë por procedural u bë në 12 vendvotime. Së dyti, kutitë duhet të mbyllen dhe sigurohen me shirita me numër serik dhe pastaj numrat serik të regjistrohen. Në rundin e parë të zgjedhjeve kjo nuk ishte e qartë në dy raste, kurse në një rast në balotazh nuk ishte vërejtur që numrat serik të regjistrohen.

Mbyllja e Vendvotimeve


Mbyllja e vendvotimeve është e paraparë të bëhet në orën 19:00 përveç në raste kur në atë kohë ka votues që presin në radhë. Në këtë rast, komisionerët duhet të lejojnë të votojnë të gjithë ata që qëndrojnë në radhë për të votuar në orën 19:00. Kryesisht, mbyllja e vendvotimeve u bë me kohë dhe me rregull në zgjedhjet e 22 tetorit dhe balotazhin me 19 nëntor. Me 22 tetor, 75 vendvotime ishin evidentuar që qëndruan hapur pas orës 19:00 si rezultat i votuesve në radhë. Ndërsa 3 vendvotime ishin evidentuar të jenë mbyllur disa minuta para orës 19:00; Prizren (*Sh.F. Dëshmorët e Zhurit* 10 minuta para 19:00), Lipjan (*Sh.M. Haxhi Zeka* 5 minuta para 19:00) dhe Istog (*Sh.F. Topliqan* gati gjysmë ore para 19:00). Në zgjedhjet për balotazh 12 vendvotime qëndruan hapur pas orës 19:00 për arsye të radhës.



Qasje për Personat me Aftësi të Kufizuar


Qasja e qendrave të votimit nga personat me aftësi të kufizuar mbetet një sfidë në një pjesë të madhe të tyre. Megjithatë raportohet për një përmirësim nga zgjedhjet lokale të 2013-së. Vëzhguesit tanë në 37% të qendrave të votimit raportuan për pengesa për qasje në qendrat të votimit nga personat me aftësi të kufizuar. Ndërsa në 19% të qendrave votimit është raportuar që ka pengesa brenda qendrave për t'iu qasur vendvotimeve. Për shkak se shumë nga qendrat e votimit janë shkolla fillore dhe të mesme, një përgjegjësi e madhe këtu qëndron tek institucionet e arsimit për mos-sigurimin e kësaj qasje. Megjithatë, institucionet e zgjedhjeve duhet të sigurojnë qasje të lehtë të të gjithë votuesve, përfshirë personat me aftësi të kufizuar dhe personat e moshuar.

Pengesa për Qasje të Qendrave të Votimit
për Personat me Aftësi të Kufizuar




Materiale Propaganduese Partiake

Prania e materialit propagandues në afërsi prej 100m nga qendra e votimit dhe brenda qendrës së votimit është e sanksionuar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), nenin 85. Përderisa KKZ-të duhet kujdesur që materiali i kandidatëve garues dhe partive të tërhiqet nga afërsia e vendvotimeve para heshtjes zgjedhore, propaganda politike brenda vendvotimit duhet të parandalohet nga menaxherët e qendrave të votimit.



Vëzhguesit tanë raportuan se 4,5% të qendrave të votimit me 22 tetor kishin materiale propaganduese (billboard, posterë) në afërsi të vendvotimeve ndërsa 3,6% qendrave të votimit kishin material propagandues në zgjedhjet për balotazh. Të dhënat tona tregojnë që komunat ku janë vërejtur më së shumti materialet propaganduese afër qendrave të votimit janë në Prizren (10 raste), Gjilan e Mitrovicë (nga 8 raste), Klinë, Prishtinë, Skenderaj (nga 7 raste), Viti (6 raste), Gjakovë, Pejë, Podujevë (5 raste), ndërsa në 15 komuna tjera një deri në katër raste janë vërejtur këso materiale afër qendrave të votuesve.

Por rastet më serioz të fushatës partiake në ditë të zgjedhje janë ato që ndodhin në ditën e zgjedhjeve brenda qendrave të votimit. Të dhënat e raportuesve tanë evidentojnë 101 raste kur në vendvotime është shfaqur një lloj i materialit partiak në zgjedhjet e 22 tetorit ndërsa 27 raste në zgjedhjet për balotazh.



Disa nga këto raste që vlen të cekem ishin në zgjedhjet për balotazh, në qendrën e votimit 0803 C në vendvotimin 01R në shkollën “Emin Duraku” në komunën e Klinës, ku dy persona pasi kanë votuar kanë treguar publikisht fletëvotimin para të gjithë të pranishmëve. Një rast i njëjtë është edhe në qendrën e votimit 0810 C në vendvotimin 01R në shkollën fillore “Dëshmorët”, komuna e Klinës, një person pasi ka votuar publikisht ka shpalos votën dhe ka treguar se për kë ka votuar.

Në zgjedhjet e 22 tetorit, në qendrën e votimit 1905E në vendvotimin 04R në shkollën “Shtjefën Gjeqovi” në Prishtinë në kabinën e votimit është gjetur lista me të cilat votuesit janë udhëzuar për kë të votojnë. Ndërsa në vendvotimin 05D në listën e kandidatëve po ashtu janë hasur udhëzime se për kë duhet të votojnë. Në Kllokot, një anëtar nga radhët e Listës Serbe është arrestuar nga policia për shkak se para qendrës së votimit “Sveti Sava” kishte tentuar të ndikoj tek votuesit duke i orientuar se kë ta votojnë. Në qendrën e votimit 0805 C në vendvotimin 01R në shkollën “Ali Krasniqi” në komunën e Klinës, brenda në kabinën e votimit është evidentuar shënjimi i njërit prej emrave të kandidatëve për kryetar. Në Podujevë, në qendrën e votimit 1808 E në vendvotimin 01R në shkollën “Emin Duraku” prapa kabinës së votimit të këtij vendvotimi është gjetur një broshurë me emra të kandidatëve të LDK-së. Në qendrën e votimit 1408D në vendvotimin 01D në shkollën “Nushi dhe Tefiku” në komunën e Novobërdës një kandidat i LDK-së për kuvend komunal është parë tek shpërndan kartëvizita për njerëz që futen për të votuar.

Gjitha këto raste me material partiak dhe bërje fushate në ditë të zgjedhjeve janë të papranueshme dhe të sanksionueshme. Në disa raste, komisionerët morën veprime të menjëhershme kurse në disa raste tjera komisionerët dhe menaxherët e qendrave të votimit ishin më tolerant ndaj këtyre dukurive.

Materiali Zgjedhor në Ditën e Zgjedhjeve

Prezenca e materialit zgjedhor që mundëson votimin është esencial për procesin e votimit. Institucionet zgjedhore të Kosovës tashmë kanë përvetësuar logjistikën e organizimit të zgjedhjeve që është mjaft e ndërlikuar kudo ku organizohen zgjedhjet. Në ditën e zgjedhjeve me 22 tetor dhe në balotazh materiali zgjedhor ishte i shpërndarë me rregull në tërë vendin, megjithatë në këto zgjedhje u paraqiten disa ngatërresa të theksuara në disa komuna që nuk ishin vërejtur në zgjedhjet e mëhershme nga Demokracia në Veprim. Problemet u paraqitën në komunën e Deçanit me mungesë dhe ngatërresa të vulave dhe mospërputhje ndërmjet dengjeve të fletëvotimeve për kryetar komune dhe atij për kuvend komuna në Klinë, Suharekë e Mitrovicë e cila rezultoi edhe me ndalime të disa kryesuesve të vendvotimeve.

Në përgjithësi, në mëngjes në kohën e hapjes së vendvotimeve, në 2.4% të vendvotimeve në nivel vendi kanë munguar materialet zgjedhore. Në komunën e Deçanit në 22 vendvotime janë evidentuar parregullsi me vulën për vulosjen e fletëvotimeve të cilat kanë shkaktuar vonesa në hapjen e vendvotimeve si dhe në mbylljen e përkohshme të tyre. Parregullsi të tjera janë lidhur me raste të izoluara të mungesës së Librit të Votimit si dhe mungesës së fletëvotimeve.

Mungesa e Vulave për Fletëvotime

Mungesa dhe ngatërresa e vulave ishte një fenomen i shfaqur në mëngjes në komunën e Deçanit. Nuk ishte e qartë nga vëzhguesit tonë nëse kjo ishte diçka me një qëllim të keq apo thjeshtë një ngatërresë e institucioneve zgjedhore. Megjithatë, ky fenomen ishte i shfaqur në një pjesë të madhe të komunës së Deçanit. Në qendrën e votimit 0105C në vendvotimet 03R, 04R dhe 05D në shkollën “Bajram Curri” në komunën e Deçanit, vendvotimi nuk është hapur për shkak të mungesës së vulave për vulosjen e fletëvotimeve. Në qendrën e votimit 0101X në vendvotimi 04 R në shkollën “Lidhja e Prizrenit” në këtë komunë vendvotimi nuk është hapur deri në orën 8 për shkak të mungesës së materialit. Në qendrën e votimit 0101 C në vendvotimin 01R në shkollën “Vëllezërit Frashëri” në komunën e Deçanit, zëvendës drejtori i shkollës në ora 7:20 e kishte marrë vulën për vulosjen e fletëvotimeve dhe nuk e kishte kthyer deri në kohën e raportimit me 7:45. Në qendrën e votimit 0112C në vendvotimin 02D në shkollën “Rexhep Kadrijaj” në fshatin Rastavicë, vendvotimi ishte mbyllur pasi që ishin marrë vulat për vulosjen e fletëvotimeve. Në të njëjtën shkollë në vendvotimin 05 R edhe pse ishte hapur vendvotimi në ora 7:00 prapë ishte mbyllur pas 10 minutash, për shkak të mungesës së vulës, së paku deri në kohën e raportimit në ora 08:06. Në qendrën e votimit 0114C në vendvotimin 02R në shkollën “Dëshmorët e Kombit”, vendvotimi ishte hapur në orën 7:00 ndërsa ishte mbyllur po ashtu, për shkak të mungesës së vulës.

Në qendrën e votimit 0108C në vendvotimin 03R në shkollën “Isa Boletini”, vendvotimi është hapur në orën 7:03 ndërsa është mbyllur menjëherë pasi që kishte pas problem me vulën për vulosjen e votave. Vendvotimi ishte hapur sërish pas orës 08:07. Po në këtë qendër të votimit, në vendvotimin 04 R vendvotimi kishte mbetur i mbyllur nga ora 07:10 deri në ora 8:10 për shkak të problemit me vulë. Ndërsa në vendvotimin 05D vendvotimi kishte mbetur i mbyllur nga ora 7:00 deri në orën 8:15, po për shkak të mungesës së vulës. Në qendrën e votimit 0102C në vendvotimin 01R në shkollën “Sylë Alaj” në komunën e Deçanit vendvotimi ishte hapur me kohë ndërsa për shkak të problemit me vulë ishte mbyllur vendvotimi dhe koha e thirrjes 08:14. Edhe në vendvotimin 02R po në këtë qendrën të votimit, vendvotimi është mbyllur pas

15 minutash pasi që ka munguar vula. Po ashtu në vendvotimin 03R vendvotimi kishte mbetur i mbyllur nga ora 07:05 deri në orën 08:20 kur ishte rihapur sërish për shkak të mungesës së vulës. Po në këtë qendër të votimit në vendvotimit 05R nga fillimi i votimit deri në ora 8:00 kishte mbetur i mbyllur për shkak të mungesës së vulës në këtë vendvotim.

Në qendrën e votimit 0110C në vendvotimin 01R, në shkollën fillore “Lan Selimi”, nga ora 07:08 deri në ora 08:24 për shkak të mungesës së vulave. Më pastaj, vendvotimi u hap. Në qendrën e votimit 0106C në vendvotimit 03D në shkollën “Avni Rustemi” në komunën e Deçanit vendvotimi ishte hap në ora 7:00 ndërsa është mbyllur në ora 7:50 për shkak se ju kishte marr vula, nuk raportohet se nga kush. Në qendrën e votimit 0103C në vendvotimin 03R në shkollën “Drita” vendvotimi është mbyllur nga ora 07:10 deri në 08:20 për shkak të problemit me vulë.

Mospërputhja e fletëvotimeve

Pjesa e dytë e ditës së zgjedhjeve të 22 tetorit, përkatësisht pas orës 12:00, është shoqëruar me një parregullsi të pa shënuar më parë. Është raportuar për ndërprerje të procesit të votimit në një numër të vendvotimeve në komuna të ndryshme të vendit, për shkak të diskrepancës në mes të numrit të fletëvotimeve për kryetar komune dhe fletëvotimeve për kuvend komunal. Pas raportimit të këtyre rasteve policia ka arrestuar një numër të kryesuesve të vendvotimeve. Raste të tilla janë evidentuar më shumë në komunën e Mitrovicës, Klinës, Suharekës, dhe në Prishtinë.

Pas këtyre rasteve kishte pasur edhe arrestime të kryesuesve të vendvotimeve. Rastet specifike përfshijnë: Në qendrën e votimit 0802 C në vendvotimin 01R në shkollën Isa Boletini në komunën e Klinës ka një votë diferencë mes dengjeve të fletëvotimeve për kryetar dhe kuvend komunal të cilat kanë 50 fletëvotime. Një fletëvotim ka tepruar nga dengju i fletëvotimeve për kuvend komunal, gjë që ka bërë që vendvotimi të mbyllet për 30 minuta. Problem i njëjtë ishte evidentuar në qendrën e votimit 2403A në vendvotimin 06D, në shkollën Edit Durham në Suharekë. Dy fletëvotime për kuvend komunal kanë tepruar. Po ashtu në qendrën e votimit 0401D në vendvotimin 03R, në shkollën Abaz Ajeti në komunën e Gjilanit, dy fletë votime për kuvend komunal kishin mbet të pashfrytëzuara.

Në Mitrovicë, në qendrën e votimit 1113 B në vendvotimin 01R, në shkollën “Trepça” nuk kishte përputhje në mes fletëvotimeve të shfrytëzuara për kryetar komune dhe fletëvotimeve për këshilltar komunal. Policia kishte arrestuar kryesuesin e vendvotimit. Në qendrën e votimit 1102 B në vendvotimin 01 R në shkollën “Migjeni” nuk kishte përputhje në mes fletëvotimeve në mes kryetarit dhe në fletëvotimeve për kandidat për kuvende komunale. Kryesuesi i vendvotimit është arrestuar edhe këtu. Po ashtu, në qendrën e votimit 1102 X në dy vendvotime, në shkollën “Abdullah Shabani” nuk kishte përputhje në mes fletëvotimeve të shfrytëzuara për kryetar komune dhe fletëvotimeve për këshilltar komunal. Policia i ka arrestuar dy kryesues të vendvotimeve. Në qendrën e votimit 1117 B në vendvotimin 02D, në shkollën “Shemsi Ahmeti” nuk ka përputhje në mes fletëvotimeve të shfrytëzuara për kryetar komune dhe fletëvotimeve për këshilltar komunal. Policia i ka arrestuar kryesuesin e vendvotimit.


Në Prishtinë, në qendrën e votimit 1905 E në vendvotimin 01R në shkollën “Shtjefën Gjeqovi”, kryesuesi i vendvotimit e ka mbyll vendvotimin për 10 minuta pasi që nuk ka pas përputhje në mes të fletëvotimeve për kryetar dhe fletëvotimeve për kandidat për asamble komunale.

Mungesa nga lista e votuesve

Mungesa e listës së votuesve u raportua në një vendvotim (1124B/01) fshati Kaçandoll, shkolla fillore "Bislim Hajdari", pasi ky vendvotim nuk ishte funksional deri pas orës 10:30. Kryesuesi ishte shoqëruar nga policia, ndërkohë që një anëtar tjetër i këshillit të vendvotimit është caktuar në vend të tij. Pas pajisjes me Listën Përfundimtare të Votuesve kishte vazhduar procesi i votimit.

Mungesa tjera të materialit zgjedhor

Gjatë procesit zgjedhor të 22 tetorit, kishte rast kur vendvotimet nuk u hapën apo u ndërprerë si shkas i mungesës së materialeve zgjedhore në tërësi apo mungesë të fletëvotimeve, mungesë së librit të vendvotimit. Në qendrën e votimit 3804B në vendvotimin 01D në shkollën "Sveti Sava" në fshatin Suhodoll i Epërm në komunë e Mitrovicës së Veriut nuk ishte hap vendvotimi deri në orën 7:45 pasi që mungonin materialet zgjedhore. Në qendrën e votimit



1915E në vendvotimin 06R në shkollën "Iliria" në Prishtinë, në këtë vendvotim ka mungesë të fletëvotimeve. Në qendrën e votimit 1706C në vendvotimin 09R në shkollën "7 Shtatori" në komunën e Prizrenit kishte munguar libri i votimit. Në qendrën e votimit 1116B në vendvotimin 01R në shkollën "Elena Gjika" në komunën e Mitrovicës po ashtu kishte munguar libri i votimit.

Ndër materialet zgjedhore jo-sensitive janë dhe: informatat si të votohet dhe listat e kandidatëve garues për kuvend komunale. Vëzhguesit tanë evidentuan disa vendvotime në zgjedhjet e 22 tetorit ku munguan këto material. Listat e kandidatëve nuk ishte prezentë në 27 vendvotime ndërsa informatat se si të votohet nuk u vërejtën në 31 vendvotime.


Një rast teknik problematik me fletëvotimi është paraqitur në Drenas, ku në qendrën e votimit 0311E në vendvotimin 02R në shkollën "Luigj Gurakuqi" është vërejtur që se disa fletëvotime kanë qenë të shtypura me një vizë tek subjekti Nisma. Rrjedhimisht komisionerët kanë hequr komplet dengun prej 50 votash nga përdorimi.

Ndërsa në zgjedhjet për balotazh, mungesa apo ngatërresa e materialeve zgjedhore nuk ishte edhe aq e theksuar megjithëse kishte disa probleme të izoluara. Sa i përket mungesës së materialit zgjedhor, nga terreni është raportuar se në 60 vendvotime kanë munguar materialet zgjedhore në kohën e hapjes së vendvotimeve (apo në 3.4% të vendvotimeve). Prijnë komuna e Gjilanit dhe Mitrovicës (me nga 8 raste), Klina dhe Prishtina (me nga 7 raste) dhe Gjakova (6 raste).

Në 10 vendvotime në nivel vendi vëzhguesit e DnV-së, kanë raportuar për prani të më pak se tre komisionerëve në vendvotim. Komunat ku kjo dukuri ka qenë më e shprehur janë: Prizren (në 3 raste), Rahoveci (në 2 raste).

Persona të Paautorizuar


Prania në vendvotim e personave si: kandidatë nëse nuk janë duke votuar, policë apo persona tjerë që nuk janë komisionerë apo vëzhgues të akredituar nuk është e autorizuar në vendvotime, gjatë procesit të votimit apo procesit të numërimit, përveç nëse kërkohet nga kryesuesi i këshillit të votimit. Megjithatë, vëzhguesit tanë evidentuan disa raste, edhe pse të pakta, të personave të paautorizuar në procesin e votimit dhe procesin e numërimit.



Në zgjedhjet e 22 tetorit, 44 raste u evidentuan ku persona të paautorizuar ishin në vendvotimi në komunat si Mitrovicë (3), Rahovec (3), Ferizaj (2), Prizren (2), Prishtinë (1), Gjakovë (1) si dhe Gjilan, Pejë, Istog dhe Fushë Kosovë. Edhe në zgjedhjet për balotazh me 19 nëntor u evidentuan 21 raste të personave të paautorizuar. Podujevë në 4 vendvotime, Gjakovë dhe Prizren në nga 3 vendvotime, në Mitrovicë, Prishtinë, Istogu në nga 2 vendvotime. Në qendrën e votimit 1802X në vendvotimin 03R në shkollën "Naim Frashëri" në komunën e Podujevës, qëndruan 6 vëzhgues të partisë LDK. Në zgjedhjet për balotazh, në komunën e Prizrenit, në disa vendvotime, persona me akreditim të skaduar kanë qenë prezent në vendvotim.

Votimi Familjar

Votimi familjar është një dukuri që vazhdimisht ka qenë prezentë në një masë të konsiderueshme në zgjedhje të Kosovës, pra votimi ku prapa kabinës për votim qëndron më shumë se një person, dy apo tre familjar ku njëri familjar udhëzon tjetrin si të votoj. Edhe pse në shumë rast kjo është për arsye se një familjar nuk është i sigurt se si të mbush fletëvotimin, megjithatë ky lloj votimi cenon fshehtësinë e votës. Në përgjithësi, gjatë këtyre zgjedhjeve lokale ka një rënie të rasteve që lidhen me votimin familjar në raport me zgjedhjet parlamentare. Votimi familjar është evidentuar në gjithsej 3,060 raste në një-të-tretën e vendvotimeve. Komunat që prijnë me votime familjare janë: Prizreni, Ferizaj, Prishtina, Peja, Gjakova dhe Gjilani. Megjithatë këto janë komuna të mëdha me më shumë vendvotime. Kurse në proporcion me numrin e votuesve dhe vendvotime më e theksuar del të jetë në Klinë, Istog, Rahovec dhe Vushtrri. Në zgjedhjet për balotazh, votimi familjar është evidentuar 21% të vendvotimeve ku prijnë Prishtina, Ferizaj, Prizren, Gjakova dhe Mitrovica.



Fshehtësia e Votës


Si në të gjitha ciklet zgjedhore edhe në zgjedhjet lokale 2017, janë shënuar raste të votimit jashtë kabinave të votimit (ose publikimit të votës), ndërsa asistimi i votuesve më shumë se një herë është shënuar në gjithsej 193 raste, në 65 vendvotime (ose në përqindje 2.6 % të vendvotimeve). Prijnë komunat: Peja (40 raste), Suhareka (31) dhe Prizreni (28).

Në balotazh, vëzhguesit e DnV-së kanë hasur në raste të votimit jashtë kabinave të votimit, ku përgjatë ditës së zgjedhjeve janë evidentuar gjithsej 29 raste (1.6% e të gjitha vendvotimeve). Në komunat: Prizren, Suharekë dhe Podujevë në nga 3 vendvotime, Rahovec dhe Klinë në nga 2 raste; Mitrovicë, Gjakovë, Gjilan dhe Obiliq me nga një rast.

Fotografimi

Fotografimi i votës nga ana e votuesve, një praktikë që mund të lidhet me blerjen e votës dhe e ndaluar nga KQZ tanimë për disa zgjedhje, është raportuar edhe kësaj radhe në disa vendvotime. Vlen të theksohet se policia ka shoqëruar një numër të caktuar të votuesve të raportuar për fotografim të votës dhe ndërmarrjen e procedurave përkatëse. Në zgjedhjet e 22 tetorit kjo dukuri u evidentua në 121 vendvotime (apo 5.2% të gjitha vendvotimeve të raportuara). Vendvotimet me së paku një fotografim të votës nga votuesit ishin evidentuar të jenë 20 vendvotime në Prishtinë, 17 vendvotime në Skenderaj, 17 vendvotime në Shtime, 17 vendvotime në Prizren, 16 vendvotime në Ferizaj, 10 vendvotime në Pejë, 8 vendvotime në Gjilan, 6 vendvotime në Mitrovicë dhe 42 vendvotime në komuna tjera. Po ashtu, në zgjedhjet për balotazh, kjo dukuri u evidentua në 70 vendvotime (4,2% të raportuara).

Disa raste që kanë shkaktuar probleme në proces zgjedhor, kanë qenë ato në qendrën e votimit 2419A në vendvotimin 02D në shkollën “28 Nëntori” në komunën e Suharekës, kryesuesi i vendvotimit ka votuar me kusht por gjatë votimit e ka fotografuar fletëvotimin e tij, si dhe ajo në Graçanicë, në qendrën e votimit 3401E në vendvotimin 09D në shkollën “Kraj Milutin” një person në ora 9:30 ka tentuar të fotografojë fletëvotimin, është ndaluar dhe është nxjerrë jashtë nga policia.



Asistimi i parregullt i votuesve

Rregullat zgjedhore specifikojnë qartë nëse një votues ka nevojë për asistim si dhe kush mund të asistoi. Një person mund të ndihmojë një person tjetër vetëm njëherë nëse votuesi e kërkon një ndihmës. Megjithatë, shumë herë kjo lloj asistence abuzohet nga persona që asistojnë më shumë se një votues. Në zgjedhjet e 22 tetorit, asistimi i votuesve më shumë se një herë është shënuar në gjithsej 193 raste, në 65 vendvotime (ose në përqindje 2.6 % të vendvotimeve). Prijnë komunat: Peja (40 raste), Suhareka (31) dhe Prizreni (28). Në rivotimin në komunën e Istogut me 17 dhjetor, votimi me asistencë u vërejt të jetë tejet i lartë dhe u raportua edhe për votim me asistencë të parregullt.

Një rast më i theksuar i asistimit më shumë se një herë është evidentuar në qendrën e votimit 2101B në vendvotimin 05D në shkollën “Anton Çetta” në komunën e Skenderajt. Banorët e shtëpisë së pleqve janë asistuar nga i njëjti person për të votuar dhe një gjë e tillë nuk është ndaluar. Në qendrën e votimit 2037 A në vendvotimin 01R, në shkollën “Svjetlost” në komunën e Prizrenit një person ka votuar në emër të dy vajzave të tij me aftësi të kufizuar fizike. Një rast tjerë që ka penguar procesin e votimit për një kohë të shkurtë ka qenë në Gjilan, në qendrën e votimit 0401D në vendvotimin 11R në shkollën “Abaz Ajeti”, ku një person ka asistuar një votues duke votuar ndryshe nga vullneti i tij. Në Prishtinë, në qendrën e votimit 1906 E në vendvotimin 07R në Fakultetin Filologjisë vendvotim është mbyllur përkohësisht pasi një person ka asistuar më shumë se një herë votuesit për të votuar.


Në zgjedhjet për balotazh, vëzhguesit e DnV-së po ashtu raportuan edhe për rastet e asistimit të votuesve më shumë se një herë, dukuri kjo e cila është evidentuar në 27 vendvotime (1.5% e të gjitha vendvotimeve). Në komunën e Gjakovës nga terreni është raportuar që disa herë ka pasur votime me asistencë, ndërsa asistimi nuk është bërë sipas rregullave që parashihen me ligj. Në ato vendvotime personi ka votuar për veten e tij dhe për personin që ka asistuar. Në Prishtinë, në qendrën e votimit 1906 E në vendvotimin 07R në Fakultetin Filologjisë vendvotim është mbyllur përkohësisht pasi një person ka asistuar më shumë se një herë votuesit për të votuar.

Në rivotim për kryetarin e Istogut, në disa prej vendvotimeve, vëzhguesit tanë raportuan për asistencë deri në 20% të numrit të përgjithshëm të votuesve që kanë votuar në ato vendvotime. Në vendvotimet tjera, kryesuesit e Këshillave të Vendvotimeve regjistruan

asistimet në Librin e Votimit. Megjithatë numri i lartë i votimeve me asistencë, sidomos kur kishte edhe votues të ri në moshë që kërkonin asistencë, mbetet e dyshimtë. Prandaj, Prokuroria e Shtetit do të duhej të verifikojë nëse këto raste janë të ndërlidhura me veprën penale cenimi i përcaktimit të lirë të votuesve.

Tentim për Votim të Dyfishtë

Zgjedhjet vazhdojnë t'i përcjellin disa votues qëllimkeq që tentojnë të votojnë më shumë se një herë. Tentime për të votuar më shumë se një herë u evidentuan në 55 raste në zgjedhjet e 22 tetorit, ndërsa 11 raste në zgjedhjet për balotazh. Më së shpeshti ndodhi në këto komuna Ferizaj (13 raste), Mitrovica (8 raste), Prizreni (2 raste). Ndërsa në zgjedhjet për balotazh prijnë komunat: Vushtrri në 2 vendvotime, ndërsa në Gjakovë, Prishtinë, Podujevë, Klinë, Mitrovicë, Suharekë, Ferizaj dhe Istogu në nga 1 vendvotim.



Ndër rastet që u evidentuan nga vëzhguesit e Demokracisë në veprimi ishin: në Prizren, në qendrën e votimit 2004A në vendvotimin 03R në shkollën “Motrat Qiriaz” një person kishte tentuar të votojë në emër të personit të vdekur ndërsa kryesuesi i vendvotimit e kishte anuluar votën si të pavlefshme. Në Prishtinë, në qendrën e votimit 1918E në vendvotimin 05 D në shkollën “Gjin Gazulli”, janë lejuar dy persona që të votojnë përkundër faktit se gishtërinjtë e tyre kanë qenë të shënjuar me sprej. Ndërsa në balotazh, në qendrën e votimit 1906 E në vendvotimin 08R në Fakultetin Filologjik në komunën e Prishtinës, një person përkundër që e kishte pas gjurmë të lëngut spërkatës në gishtërinj i është lejuar që të votojë. Për këtë është njoftuar edhe KQZ-ja para se të votojë, megjithatë është lejuar votimi.

Parregullsi dhe Incidentet me Dhunë apo Kërcënim


Përpos dukurive të përmendura më lartë, vëzhguesit e Demokracisë në Veprim kanë raportuar edhe për disa parregullsi dhe incidente që kanë çrregulluar procesin e votimit për një kohë, megjithëse këto fatmirësisht kanë qenë të pakta për të ndikuar procesin në tërësi në ndonjë komunë. Të dhënat e DnV-së tregojnë që në zgjedhjet e 22 tetorit, u raportuan 26 këso incidentesh dhe në 19 prej këtyre rasteve rezultuan me mbyllje të përkohshme apo pengim të procesit zgjedhorë. Ndërsa në zgjedhjet për balotazh, kishte 12 këso incidentesh prej të cilave 5 rezultuan në mbyllje apo pengim të përkohshëm të votimit.

Në komunën e Graçanicës u paraqitë tri raste të tilla, e para ndodhi në shkollën “Kralj Milutin” në Komunën e Graçanicës, gjatë procesit të votimit ka ndodhur një përlëshje fizike në mes të disa votuesve, për çka ka ndërhyrë policia duke i shoqëruar në stacion policor këta votues. Ky incident ka ndikuar për disa minuta në pengimin e procesit të votimit dhe mund të cilësohet si incident i izoluar. Po ashtu në këtë qendër të votimit, policia ka arrestuar edhe një komisioner nga radhët e Gradanska Iniciativa për shkak se qëllimshëm ka dëmtuar kutinë e votimit duke e goditur atë. Ndërsa, në vendvotimin 09D në këtë shkollë një person në ora

9:30 ka tentuar të fotografojë fletëvotimin, është ndaluar dhe është nxjerrë jashtë nga policia. Në Kllokot, një anëtar nga radhët e Listës Serbe ishte arrestuar nga policia për shkak se para qendrës së votimit “Sveti Sava” kishte tentuar të ndikoj tek votuesit duke i orientuar se kë ta votojnë. Në qendrën e votimit 2110B në vendvotimin 02D në shkollën “Skënder Skënderi” në komunën e Skenderajt vazhdimisht ka tentime që më shumë se dy persona të qëndrojnë prapa kabinës. Por asnjëherë nuk janë lejuar.

Incidente më pak serioze por që shkaktuan disa pengesa ishin: në komunën e Gjilanit, në qendrën e votimit 0438 D në vendvotimin 01D në shkollën “Bajram Curri” një person vazhdimisht ka sjellë votues dhe është paraqitur herë si komisioner e herë si vëzhgues. Në komunën e Mitrovicës, në qendrën 1121B/02D të shkollës “Mehë Uka” një person është lejuar që të votoj me ID të fotokopjuar. Në qendrën e votimit 5201A në vendvotimin 02R në shkollën “Anadollu” në Komunën e Mamushës një person në orën 11:30 ka votuar me dokument identifikimi të gruas së tij. Një votues ka raportuar se emri i tij ka qenë paraprakisht i nënshkruar në Listën e Votuesve në Prishtinë 1921E/01R në shkollën “Asim Vokshi” në Prishtinë. Një komisioner i Lëvizjes Vetëvendosje ka dhënë identitetin e rremë dhe si pasojë është larguar nga vendvotimi në komunën e Istogut në shkollën “Ndre Mjeda”. Në Mitrovicën qendrën e votimit 3805B në vendvotimin 11R në shkollën “Sveti Sava” në Mitrovicën e Veriut në orën 11 një grua ka shikuar komplet librin e nënshkrimeve me pretendimin se po e shikon se kush ka votuar dhe më pas ka thënë se edhe ajo donë të votojë.

Në rivotim për Istog, në qendrën e votimit 0621C, në fshatin Kaliqan, kontrollimi me llambë ultra violetë, nuk u bëhet në mënyrë të rregullt në të gjitha rastet duke kontrolluar vetëm njërën dorë.



Ndërsa në zgjedhjet për balotazh disa incidentet që shkaktuan disa pengesa të vogla ishin në qendra e votimit 0805 C në shkollën “Ali Krasniqi” në komunën e Klinës në ora 07:45 ishte goditur nga jashtë me gurë, duke i dëmtuar derën e hyrjes. Policia kishte qenë në vendin e ngjarjes por autorët nuk ishin identifikuar. Ishte raportuar edhe për raste ku disa persona kanë votuar jashtë kabinës së votimit, në shkollën “Hysni Zajmi”, QV 0606C, vendvotimi 04R në komunën e Istogut. Një arrestim kishte ndodhur në Mitrovicë, në qendrën e votimit 1101 B në vendvotimin 01R në shkollën “Shaban Idrizi”, ku një personit i është gjetur një kopje e fletëvotimit në xhep, i cili është arrestuar nga Policia. Në qendrën e votimit 0401D në vendvotimin 11R në shkollën “Abaz Ajeti” në komunën e Gjilanit, një person ka asistuar një votues duke votuar ndryshe nga vullneti i tij. Kjo shkaktoi pengesë në votim për shkak të

ankesave të komisionerëve dhe vëzhguesve partiak. Në Prishtinë, në qendrën e votimit 1906 E në vendvotimin 07R në Fakultetin Filologjisë vendvotim ishte mbyllur përkohësisht pasi një person ka asistuar më shumë se një herë votuesit për të votuar.


Në balotazh në lokalitetet me shumicë serbe, banorëve të komunitetit serb u ishte bërë thirrje për të mos dal për të votuar. Raste të tilla janë raportuar në komunën e Vushtrrisë përkatësisht në fshatrat Grac dhe Banjskë dhe në komunën e Obliqit.

VII. Ankesat Zgjedhore dhe Vendimet

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Për të dy raundet zgjedhore, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në total ka pranuar 1,127 ankesa dhe apele. Prej tyre, 448 apo 38% janë refuzuar, 312 apo 27% janë pranuar, përdërisa për 415 ose 35% janë marrë vendime tjera (të paraqitura pas afatit, të palejuara ose janë konsideruar si të tërhequra).


Subjekti politik që ka bërë më së shumti ankesa është PDK me 263 ankesa, LVV me 160 dhe LDK me 151 ankesa, pasuar nga AAK dhe NISMA me nga 91, përkatësisht 82 ankesa. Nga organizatat jo-qeveritare, BIRN ka bërë 128 ankesa dhe KDI 26 ankesa.



Numri më i madh i ankesave është bërë kundër trupave menaxhuese zgjedhore, përkatësisht KQZ-së dhe KVV-ve. Përdërisa ndaj subjekteve politike më së shumti ankesa janë bërë kundër LDK-së (96), LVV (56), PDK (56) dhe AAK (45).

Sa i përket periudhës zgjedhore, numri më i madh i ankesave është bërë në momentin kur janë shpallur rezultatet përfundimtare për Kuvende Komunale, përkatësisht 511 ankesa janë bërë gjatë kësaj periudhe. Në fakt, një numër i madh i këtyre ankesave ishin bërë menjëherë pas mbylljes së vendvotimeve por ato ishin shpallur si parakohshme, duke bërë kështu që ato të grumbullohen pas shpalljes përfundimtare të rezultateve nga ana e KQZ-së. Fushata zgjedhore me 223 ankesa dhe dita e votimit (187) janë periudhat tjera kur ka pasur më së

shumti ankesa. Në anën tjetër sa i përket komunave ku pasur më shumti ankesa është komuna e Prizrenit me 127 ankesa, pastaj komuna e Prishtinës me 110 ankesa dhe Ferizaj me 74 ankesa.



Është e qartë se numri më i madh i ankesave është bërë nga kandidatët për anëtar të Kuvendeve Komunale. Dyshimet e tyre kryesore kanë qenë që rezultati i paraqitur nga KKZ-të dhe në fund nga KQZ-ja nuk është ai real që ata kanë pretenduar që kanë marrë në vendvotime. Një numër i madh i këtyre ankesave janë pranuar nga PZAP dhe është urdhëruar rinumërimi i një numri të madh të kutive nga PZAP, megjithatë vetëm për një numër shumë të vogël të rasteve ka pasur ndryshim të rezultateve, dhe rrjedhimisht edhe ndryshim në radhitje të kandidatëve. Në total janë 13 raste kur fituesi i ulëses në Kuvend komunal ka ndryshuar si rezultat i vendimeve të PZAP-së për rinumërim nga ana e QNR-së.

Vendimet më të komentuar të PZAP-së

PZAP ka marrë një numër të konsideruar të vendimeve që kanë nxitur debat në mesin e akterëve të zgjedhjeve. Disa prej vendimeve të PZAP-së kanë shkuar edhe në Gjykatën Supreme e cila në disa raste i ka rrëzuar ato paraprake të PZAP-së.

Ndër vendimet më të komentuar të PZAP-së kanë qenë ato për decertifikim 86 kandidatëve që ishin futur garës për kryetar ose anëtar të Kuvendit Komunal, vendimi për rinumërim të votave në Prishtinë, Prizren, rinumërim të pjeshëm në Dragash dhe Rahovec, si dhe rivotimi në komunën e Parteshit. Një tjetër çështje tejet e komentuar në vendimet e PZAP-së ka qenë vendimi për dënimet që janë bërë për shkak të pranisë së fëmijëve në fushata zgjedhore.



KQZ, pasi kishte certifikuar kandidatët e subjekteve politike, kishte kërkuar verifikimin nëse të njëjtit janë dënuar për vepra penale në tri vitet e fundit, ashtu siç kërkohet me LZP. Kjo ishte hera e parë që KQZ kërkonte një verifikim të tillë pas nëntë viteve prej miratimit të ligjit. Këshilli Gjyqësor i Kosovës kishte gjetur se 87 kandidatë ishin dënuar në tri vitet e fundit për vepra penale, duke bërë që KQZ të marr vendim për decertifikim të këtyre kandidatëve. PZAP kishte konfirmuar vendimin e KQZ-së, por jo edhe Gjykata Supreme, e cila pas ankesës së tre prej kandidatëve kishte konstatuar se kjo dispozitë ligjore ishte në kundërshtim me Kushtetutën. Si rrjedhojë, KQZ anuloi vendimin e saj për decertifikim dhe iu dha mundësi të gjithë kandidatëve që t'i kthehen garës zgjedhore.



Pak a shumë njëjtë kishte ndodhur edhe me vendimin e PZAP për rinumërim të votave në komunën e Prishtinës dhe Prizrenit. Fillimisht PZAP kishte miratuar ankesat e PDK-së dhe LDK-së për rinumërim të të gjitha kutive të votimit në këto dy komuna, por Gjykata Supreme i kishte rrëzuar këto dy ankesa si të pabazuara. Përderisa në anën tjetër, vendimi i PZAP për rivotim për komunën e Istogut ishte ri-konfirmuar nga Gjykata Supreme, dhe kështu kjo komunë do të jetë komuna e dytë pas asaj të Parteshit që shkon në rivotim në këto zgjedhje lokale.

Me 02 nëntor 2012, PZAP kishte vendosur që të dërgojë në rivotim komunën e Parteshit për zgjedhjet për kryetar komune në raundin e parë, për shkak se, sipas PZAP-së, veprimet e ndërmarra nga njëri prej kandidatëve për kryetar kanë pasur ndikim tek votuesit. Kjo çështje ishte dërguar edhe në Gjykatën Supreme, por e njëjta vetëm ka konfirmuar vendimin e PZAP-së. Si rezultat raundi i parë i zgjedhjeve në Partesh ishte përsëritur në raundin e dytë të zgjedhjeve që ishte mbajtur me 19 nëntor në komunat tjera. Duke pasur parasysh që në këtë komunë kishte vetëm dy kandidatë, nuk kishte nevojë për një raund shtesë të zgjedhjeve.



Gjobat ndaj subjekteve politike

Sa i përket dënimeve, PZAP ka shqiptuar më së shumti dënime ndaj LDK-së, me gjithsej 70,300.00 €, pasuar nga PDK me 22,450.00 €, LVV me 23,100.00 €, AKR me 18,500.00 €, AAK me 13,550.00 €, Alternativa me 12,950.00 €, NISMA me 2,850.00 € etj. Vlera e gjobave të shqiptuara ndaj subjekteve politike në totalë është 196,750.00 €.

KDI, si udhëheqëse e koalicionit Demokracia në Veprim, ka parashtruar në PZAP gjithsej 26 ankesa, prej të cilave 21 janë aprovuar. Vlera e gjobave të shqiptuara ndaj subjekteve politike nga ankesat e dorëzuara nga KDI është 12,350 €.

VIII. Pjesëmarrja e Votuesve

Pjesëmarrja e votuesve në zgjedhjet lokale të 22 tetorit ishte më e lartë se zgjedhjet e përgjithshme, një trend që vazhdimisht po e përcjell Kosovën në zgjedhje. Megjithatë, pjesëmarrja e 43,68% votuesve me të drejtë vote del të jetë nivel më i ulët se sa në zgjedhjet lokale të vitit 2013, që ishte 46,3%, dhe në zgjedhjet lokale të vitit 2009, që ishte 44,7%. Me 22 tetor, daljen më të madhe në zgjedhje del ta ketë komuna e Mamushës me 67,5% dhe komuna e Kllokotit me 64,3%. Ndërsa daljen më të ulët me 22 tetor del ta ketë komuna e Skenderajt me 31,6% dhe komuna e Dragashit me 37,3%.



Dalja në rundin e dytë ishte më e ulët se në rundin e parë në të gjitha komunat ku kishte rund të dytë. Madje, në disa komuna drastikisht më e ulët: në Prizren dalja e votuesve ishte afër 10% më e ulët në rundin e dytë; në Gjilan ishte 13% më e ulët në rundin e dytë. Në disa komuna si Prishtina dhe Gjakova dalja ishte afërsisht e njëjtë në dy rundet. Ky trend nuk ishte i njëjtë në zgjedhjet lokale të vitit 2013.

Në rundin e dytë, në përgjithësi në lokalitetet me shumicë serbe, banorëve të komunitetit serb u është bërë thirrje për të mos dal për të votuar. Raste të tilla janë raportuar në komunën e Vushtrrisë përkatësisht në fshatrat Grac dhe Banjskë dhe në komunën e Obliqit.


Me 22 tetor, deri në mesditë dalja e votuesve ishte 14,6% ndërsa me 19 nëntor deri me 12:00, vetëm 10,2% të votuesve kishin dal për të votuar. Kjo tregon se pjesa më e madhe e votuesve votuan pas orës 12:00.

Votat e Pavlefshme


Votat e pavlefshme edhe kësaj radhe dalin të jenë problematike sidomos për zgjedhjet për kuvendet komunale, megjithëse niveli i përgjithshëm i votave të pavlefshme është pak më i ulët se në vitin 2013. Ndërsa për zgjedhje të kryetarëve edhe pse niveli i votave të pavlefshme jo fort i lartë për disa komuna e tejkalon diferencën në mes të dy kandidatëve në rundin e dytë.

Votat e pavlefshme për anëtarë të kuvendeve komunale në përgjithësi ishte 8,4% (në vitin 2013 ishte 8,6%). Kjo për shkak se fletëvotimi për kuvend komunal është më i komplikuar pasi votuesi duhet të shënjojë subjektin politik si dhe një numër tjetër që shkon për një kandidat të atij subjekti. Megjithatë, për shkak se për zgjedhjet të përgjithshme votuesi duhet të shënjoj një subjekt dhe deri në pesë numra për kandidatë të atij subjekti, shumë votues e ngatërrojnë plotësimin e fletëvotimit për kuvend komunal dhe për Kuvend të Kosovës, pra zgjedhje të përgjithshme.


Sa i përket, nivelit të fletëvotimeve të pavlefshme për komuna, më së shumti kishte në komunën e Graçanicës, diku afër 13%, dhe dy komuna tjera me shumicë serbe: Zubin Patok dhe Partesh me afër 12% dhe 11%, respektivisht. Komuna tjetër në të cilën votat e pavlefshme kaluan 10% ishte komuna e Gillogovcit. Ndërsa për nga numri, komuna e Prishtinës kishte më së shumti vota të pavlefshme, gjithsej 6.855 vota të pavlefshme, pastaj Prizren dhe Ferizaj, megjithëse përpjesëtuar me trupin votues të tyre, niveli i votave të pavlefshme në këto komuna ishte rreth 8% (shih grafikun më poshtë për më saktë). Komunat me më së paku vota të pavlefshme për kuvend komunal ishin ajo e Mamushës dhe Junikut. Të gjitha të tjerat kishin më shumë se 6% vota të pavlefshme që del të jetë një nivel mjaft i lartë.



Për kryetar të komunës, niveli i votave të pavlefshme ishte normalisht më i ulët. Kjo për faktin se votuesit duheshin të shënjojnë vetëm një kandidat. Në zgjedhjet e 22 tetorit kishin disa kandidatë, ndërsa në rundin e dytë, për ato komuna ku kishte rund të dytë, votuesit kishin vetëm dy kandidatë. Në zgjedhjet e 22 tetorit, niveli i përgjithshëm i votave të pavlefshme për kryetar të komunës ishte 1,7%. Komuna e Graçanicës edhe për Kryetarë të Komunës doli të kishte numrin më të madh të votave të pavlefshme me diku mbi 6% të të gjitha fletëvotimeve.



Në rundin e dytë, niveli i përgjithshëm i votave të pavlefshme ishte 1,2%. Megjithatë në komnat ku rezultatit ishte tejet i ngushtë si në Prishtinë, Prizren dhe Istog, numri i votave të pavlefshme ishte më i lartë se diferenca e votave në mes të dy kandidatëve garues (edhe pse në Istog, votimi për rund të dytë u anulua dhe u ripërtëritë). Niveli më i lartë i votave të pavlefshme këtu ishte në Mitrovicë, në mbi 1,6%, megjithatë, për nga numri, më së shumti vota të pavlefshme kishte në Ferizaj (651) dhe në Prishtinë (627).



PËRKRAHUR NGA:



An EU funded project managed by the European Union Office in Kosovo



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERICKOG NARODA



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK
DANIDA | INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION



Stabilitätspakt für Südosteuropa
Gefördert durch Deutschland
Stability Pact for South Eastern Europe
Sponsored by Germany